



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 2667/5 prot.

Tiranë, më 20.11.2025

VENDIM

Nr. 39, datë 20.11.2025

PËR

ZBATIMIN E MASAVE ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, shkronja “i” e pikës 1, të nenit 7, nenit 8, nenit 9, pikës 1 dhe shkronjat “c” dhe “dh” të pikës 2 të nenit 9/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, (në vijim “LDI”),

KONSTATOVA SE:

Zyra e Komisionerit në zbatim të detyrave të lëna nga rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për Vlerësimin e Veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2024”, si dhe bazuar në Planin e Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Transparencës Proaktive 2025, ka kryer monitorimin periodik të Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve në faqen zyrtare të autoritetit publik Bashkia Cërrik.

Sipas shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 10 të LDI, Koordinatorin për të drejtën e informimit krijon, mban, publikon dhe përditëson Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të nenit 8, të këtij ligji.

Në pikën 1 të nenit 8 të LDI parashikohet: “..... Ky regjistër përditësohet jo më pak se 1 (një) herë në muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuarve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër”.

Pika 2 e nenit 8 të LDI parashikon se: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos standarde për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit”.

Në zbatim të pikës 2 të nenit 8, të LDI, Komisioneri ka miratuar formatin dhe përmbajtjen e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve me Urdhrin nr. 188/2020 “Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, të rishikuar” (në vijim Urdhri nr.188/2020 i Komisionerit).

Bazuar në sa më sipër, Zyra e Komisionerit ka kryer monitorimin periodik të Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve në faqen zyrtare të autoritetit publik Bashkia Cërrik <https://www.bashkiacerrik.gov.al/>, në përfundim të të cilit ka rezultuar se nuk është përmbushur detyrimi ligjor i përcaktuar në nenin 8 të LDI, lidhur me përditësimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, sipas dispozitave ligjore të LDI dhe sipas formatit të përcaktuar nëpërmjet Urdhrit nr. 188/2020 të Komisionerit.

Referuar pikës 2 të nenit 10, si dhe pikës 3 të nenit 19 të LDI, përgjegjësia për krijimin, mbajtjen, publikimin dhe përditësimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve është e koordinatorit për të drejtën e informimit pranë autoritetit publik Bashkia Cërrik, konkretisht znj. Aishe Baxhia.

Bazuar në konstatimet e monitorimit, Zyra e Komisionerit dërgoi pranë autoritetit publik Bashkia Cërrik fillimisht shkresën nr. 2667 prot. datë 17.10.2025 “*Mbi publikimin/përditësimin e Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve*”, duke i lënë afat deri më datë 27.10.2025 koordinatorit për të drejtën e informimit për të dhënë sqarime lidhur me arsyet e mospublikimit/mospërditësimit të Regjistrit. Në vijim të shkresës së parë, duke mos pasur asnjë reagim nga ana e koordinatorit, Zyra e Komisionerit dërgoi shkresën e dytë nr. 2667/1 prot., datë 28.10.2025, “*Njoftim për konstatimin e kundravajtjes dhe fillimin e procedurës së shqyrtimit të saj*”, nëpërmjet së cilës njoftoi konstatimin e mospërditësimit të Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, në vijim të së cilës gjithashtu nuk u parashtruan sqarime lidhur me mospublikimin/mospërditësimin e Regjistrit.

Në këto kushte, me qëllim ezaurimin e së drejtës për t’u dëgjuar, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të Kodit të Procedurave Administrative, nëpërmjet shkresës nr. 2667/1 prot., datë 28.10.2025 drejtuar znj. Aishe Baxhia, Komisioneri njoftoi zhvillimin e një seance dëgjimore, mbajtur më datë 05.11.2025.

Në seancë dëgjimore u paraqit znj. Aishe Baxhia, koordinatore për të drejtën e informimit pranë autoritetit publik Bashkia Cërrik, e cila në parashtrimet e veta deklaroi se: “*mban fizikisht Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve sipas formatit të miratuar nga Zyra e Komisionerit. Duke qenë se Bashkia Cërrik ka qenë në kohë fushate në kuadër të procesit zgjedhor për Kryetar Bashkie dhe gjithashtu ngarkesës së punës si Përgjegjëse e Njesisë së Burimeve Njerëzore nuk ka mundur të bëjë më herët publikimin/përditësimin e Regjistrit në faqen zyrtare*”. Znj. Baxhia sqaroi se do të ndërmerren masat e nevojshme për publikimin/përditësimin e Regjistrit.

Pavarësisht sa më sipër, Zyra e Komisionerit ka rimonitoruar faqen zyrtare të autoritetit publik dhe deri në datën e nxjerrjes së këtij vendimi, rezulton se koordinatori për të drejtën e informimit vijon të jetë në mospërmbushje të detyrimit ligjor lidhur me publikimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, sipas dispozitave ligjore të LDI dhe formatit të miratuar nëpërmjet Urdhrit nr. 188/2020 të Komisionerit. Ndryshe nga sa parashikohet në pikën 1 të nenit 8 të LDI ku citohet se: “Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjister të posaçëm, **ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre....**”, për asnjë kërkesë për informacion të pasqyruar në Regjister nuk është publikuar informacioni i dhënë në përgjigje të secilës.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë. Nga ana tjetër, Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve përfaqëson një nga instrumentet kryesore të promovimit të transparencës proaktive të autoriteteve publike dhe garantimit të së drejtës për informim të publikut, për rrjedhojë çdo autoritet publik është i detyruar ligjërisht për vënien në zbatim të tij.

Nga monitorimi i zhvilluar nga Zyra e Komisionerit dhe shqyrtimi administrativ më pas, rezultoi se koordinatori për të drejtën e informimit pranë autoritetit publik Bashkia Cërrik, znj. Aishe Baxhia nuk e ka përmbushur plotësisht detyrimin ligjor, si dhe provat/argumentet e dhëna janë të pamjaftueshme për të arsyetuar mospërmbushjen dhe mosrespektimin e dispozitave të LDI.

Pika 1 e nenit 18 të LDI parashikon se: *“Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni”*.

Në shkronjën “d” të pikës 2 të nenit 18, të LDI parashikohet se: *“moskrijimi, mosmbajtja, mospublikimi apo mospërditësimi i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 8, të këtij ligji, dënohet me 25 000 deri në 100 000 lekë”*.

Në pikën 3 të nenit 19 të LDI parashikohet se: *“Koordinatori për të drejtën e informimit ka përgjegjësi administrative për shkeljet administrative të parashikuara në shkronjat “d” dhe “e” të pikës 2 të nenit 18 të këtij ligji”*.

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet, që rezultuan nga monitorimi dhe shqyrtimi administrativ i zhvilluar, Komisioneri vlerëson se është shkelur detyrimi për të përditësuar Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve në faqen zyrtare në internet të autoritetit publik Bashkia Cërrik, sipas dispozitave ligjore të LDI dhe sipas formatit të përcaktuar nëpërmjet Urdhrit nr. 188/2020 të Komisionerit, mosveprim që konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në përputhje me shkronjën “d” të pikës 2 të nenit 18 të LDI. Duke marrë parasysh rrethanat e rastit, faktin që personi përgjegjës nuk është përsëritës në shkeljen e detyrimeve ligjore të sipërpërmendura dhe gjithashtu bazuar në parimin e proporcionalitetit, masa e dënimit me gjobë vlerësohet të jetë në kufirin minimal.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në shkronjën “dh” të pikës 2 të nenit 9/1, të shkronjës “d” të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22 dhe 23 të ligjit 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, të ndryshuar, ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 *“Për kundërvajtjet administrative”* dhe shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Koordinator për të drejtën e informimit pranë autoritetit publik Bashkia Cërrik të krijojë, mbajë, bëjë publik dhe përditësojë Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, në përmbushje të detyrimeve të shkronjës “b” pika 2 të nenit 10 dhe në zbatim të pikës 1 të nenit 8 ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, i ndryshuar dhe sipas Urdhrit nr. 188/2020 *“Për miratimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, të rishikuar”* të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda datës 05.12.2025.
2. Dënimin e znj. Aishe Baxhia, koordinator për të drejtën e informimit pranë autoritetit publik Bashkia Cërrik, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë.
3. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoka ekzekutohet nga zyra e financës së autoritetit publik Bashkia Cërrik, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikën 1, autoriteti publik ka të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar, si dhe nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, i ndryshuar.
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 2, bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, i ndryshuar, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bëjë ankim në gjykatë në përputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 *“Për kundërvajtjet administrative”*.

Ky vendim u shpall sot më datë 20.11.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi